



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 674, datë 08.11.2023**

**PËR**

**NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 38, DATË 28.02.2019 “PËR PAGESAT E GJYQTARËVE NË DITËT E PUSHIMIT JAVOR DHE FESTAVE ZYRTARE”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 11, pika 3 shkronja “ç” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 97, pika 1, shkronja “b” të Ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenit 91 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

**VENDOSI:**

1. Pika 2 e Udhëzimit nr. 38, datë 28.02.2019 “Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festat zyrtare”, ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“2. Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë dhe/ose gjyqtari i gjykatës së apelit kompensohet financiarisht sipas pikës 1, nëse është në listën e gatishmërisë ose gjykon çështje urgjente, për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë se duhet të vendoset brenda 24-72 orëve nga regjistrimi i çështjes në gjykatë.”

2. Ky ndryshim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**